

RAPORTI PËR KONFERENCË

# *Drejt një politike kulturore në Kosovë*

Dhjetor 2015, Prishtinë



**FORUMI  
KULTUROR**

Rrjeti i organizatave të pavarura

Rrjeti i organizatave të pavarura të  
kulturës të Kosovës

[www.forumikulturor.net](http://www.forumikulturor.net)





**FORUMI  
KULTUROR**

Rrjeti i organizatave të pavarura të kulturës të Kosovës

Rrjeti i organizatave të pavarura të kulturës të Kosovës  
[www.forumikulturor.net](http://www.forumikulturor.net)

*Prodhimi i këtij dokumenti është mundësuar me ndihmën e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, dhe Olof Palme International Center e mbështetur nga Qeveria Suedeze.*

*“Ky publikim u prodhua me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Forumit Kulturor dhe në asnjë mënyrë nuk paraqet mendimet e Bashkimit Evropian”*

RAPORTI PËR KONFERENCË

# Drejt një politike kulturore në Kosovë

**Autor:** Ebba Lekvall

**Bashkautore:** Shqipe Hajredini



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë



SWEDEN

# Hyrje

Viteve të fundit janë krijuar lidhje të qarta mes demokracisë së qëndrueshme e funksionale dhe kulturës. Shoqëritë kanë tendenca që të jenë më të hapura, tolerante, funksionale dhe ekonomikisht më të suksesshme, ku njerëzit kanë qasje të lehtë në një vistër të gjerë aktivitetesh kulturore, dhe niveli i pjesëmarrjes në to është i lartë. Aktivitetet kulturore janë pjesë e rëndësishme e krijimit të shkathtësive të qytetarëve për ta shprehur vetveten, për ta informuar vetveten, për të menduar në mënyrë kritike dhe për të pasur mendime, që të gjitha këto thelbësore për funksionim të demokracisë. Plotësimi i nevojës për përkrahjen e një numri aktivitetesh kulturore kërkon një ndjenjë të fuqishme të transparencës dhe tolerancës nga qeveritë.<sup>1</sup>

Kultura nuk kontribuon vetëm në formimin e identiteteve dhe të ndjenjës së përkatësisë, por gjithashtu pasqyron mënyra të

<sup>1</sup> 'How Does Culture Strengthen Democracies Politically, Socially, and Economically?', Këshilli i Evropës, [http://www.coe.int/t/dg4/cultureheritage/culture/digitisation/brochure\\_en.pdf](http://www.coe.int/t/dg4/cultureheritage/culture/digitisation/brochure_en.pdf).

bashkëjetesës dhe konstruksionin e referencave simbolike në shoqëritë shumëkulturore dhe pluraliste. Si e tillë, ka mundësinë t'ju jep qytetarëve 'ndjenjën e të qenit pjesë e bashkësisë, duke siguruar kështu që ata të jenë në gjendje të marrin pjesë në të dhe që kjo të konsiderohet prioritet i lartë në politikëbërje<sup>2</sup>. Megjithatë, kultura mbetet në margjinat e politikave publike në Kosovë, dhe mendimi se kultura është thjeshtë një barrë për buxhetin dhe ekonominë ende është i pranishëm.<sup>3</sup>

Përmes këtij raporti tentohet që të hedhet dritë në politikën e tanishme të kulturës në Kosovë dhe, në disa raste, që të krahasohet kjo politikë me ato të shteteve të tjera, kryesisht me atë të Suedisë dhe të Mbretërisë së Bashkuar. Thënë

<sup>2</sup> Annamari Laaksonen, *Making culture accessible: Access, participation and cultural provision in the context of cultural rights in Europe*, Council of Europe Publishing, April 2010, ISBN 978-92-871-6729-3, p. 8, <http://www.coe.int/t/dg4/culture-heritage/culture/Moscow/Laaksonen.pdf>.

<sup>3</sup> Dren Pozhegu, 'Politikat kulturore dhe ndarjet buxhetore për kulturën në Kosovë', Forumi Kulturor, Tetor 2014, f. 13.

në përgjithësi, është konstatuar se qeverisë i mungon një politikë e tillë apo edhe një strategji – edhe pse thuhet se strategjia është në hartim e sipër. Në vend të kësaj, qeveria ka shpallur disa prioritetet, të cilave u mungon vizioni dhe koherenca. Rrjedhimisht, në këtë dokument do të tentohet të jepen rekomandime për qeverinë lidhur me krijimin e një politike aktuale kulturore. Në këtë raport gjithashtu do të paraqiten fushat specifike problemore, duke përfshirë financimin e sektorit të kulturës dhe kornizën ligjore, si dhe propozimin e alternativave.

Megjithatë, nevojitet të theksohet se fushëveprimi i këtij raporti është kufizuar nga disa çështje. E para, për shkak të mungesës së informatave; faqja e internetit e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit<sup>4</sup> (MKRS) dhe ajo e Departamentit të kulturës,<sup>5</sup> kanë informata

shumë të pakta dhe duket se nuk përditësohen rregullisht. E dyta, për shkak të kufizimit kohor janë realizuar vetëm një numër i vogël intervistash, kështu që nuk ka qenë e mundur të trajtohet kultura në nivelin komunal të Prishtinës. Po kështu, për arsye të kufizimeve kohore, trashëgimia kulturore nuk është trajtuar, e as që është shtjelluar çështja e të drejtave të autorit – dy aspekte këto që janë shumë të rëndësishme për një politikë kulturore të mirë dhe duhet të jenë pjesë e saj.

4 Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, faqja e internetit: <http://www.mkrs-ks.org/?page=2.1>.

5 Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Departamenti i kulturës, faqja e internetit: <http://www.mkrs-ks.org/?page=2.7>.

# Politika kulturore në Kosovë

Sektori i kulturës është ndoshta sektori më i ndërlikuar nga aspekti i politikave në fushën e qeverisjes. Hartimi i një politike të mirë dhe të qëndrueshme të kulturës është pjesë e procesit të demokratizimit të çdo vendi; shoqëria demokratike dhe pluraliste kërkon një politikë të pavarur kulturore, e cila është e pakorruptuar dhe përkrahë lirinë e shprehjes.<sup>6</sup> Kosova ka kornizën ligjore për institucionet kryesore publike, të cilat rregullojnë sektorin e kulturës dhe të cilat do të analizohen më poshtë në tekst. Megjithatë, duket se qeveria nuk ka politikë të qartë apo madje edhe strategji për kulturë. Shumë nga të intervistuarit thanë se qeverisë i mungon vizioni për kulturë, se fjalët ‘veprim’ dhe ‘politikë’ shpesh ngatërrohen, dhe se qasja *ad hoc* e qeverisë zbatohet vetëm për mbushjen e boshllëqeve të krijuara për shkak të mospasjes

së politikës. Disa të intervistuar gjithashtu deklaruan se MKRS-ja është duke mikromenaxhuar sektorin e kulturës në vend që të jep një vizion strategjik, dhe gjithashtu është cekur se për shkak të mungesës së politikës apo strategjisë ‘shpenzimet publike vazhdojnë të mbesin kaotike’.<sup>7</sup>

Politika e kulturës zakonisht ka disa qëllime kryesore të përcaktuara nga qeveria, me objektiva apo veprime më specifike të miratuara për arritjen e këtyre qëllimeve. Për shembull, në vitin 2009 qeveria e Suedisë deklaroi se qëllimi i politikës kulturore është se ‘kultura duhet të jetë forcë dinamike, sfiduese dhe e pavarur e bazuar në lirinë e shprehjes, se çdokush duhet të ketë mundësinë e pjesëmarrjes në jetën kulturore, dhe se krijimtaria, larmia e cilësia artistike duhet të jenë strumbullar i zhvillimit shoqëror’.<sup>8</sup> Për të arritur këto qëll-

6 Intervistë me David Karlsson, kryetar i bordit në Nätverkstan, 14 qershor 2015, <http://www.natverkstan.net/>; Intervistë me Lotta Lekvall, drejtoreshë ekzekutive e Folkteatern Göteborg, anëtare e bordit të Kungliga Operan [Operës Kombëtare të Suedisë], 28 maj 2015.

7 Pozhegu, f. 13.

8 Regeringskansliet, ‘Målförkultur’, 25 shtator 2014, <http://www.regeringen.se/regeringens-politik/kultur/mal-for-kultur/>, përkthyer nga autori suedez.

lime të politikave, përmes politikës kulturore duhet të promovoj mundësinë që çdo njeri të përjetojë kulturën, të shkollohet dhe të zhvillon aftësitë e veta krijuese; të promovoj cilinë dhe risinë artistike; të promovoj trashëgiminë e gjallë kulturore të ruajtur, të përdorur dhe në zhvillim e sipër; të promovoj shkëmbimet dhe bashkëpunimet ndërkombëtare dhe ndërkulturore; dhe t'i kushtoj vëmendje të posaçme të drejtës në kulturë të fëmijëve dhe rinisë.<sup>9</sup> Qeveria ndan fonde për institucionet publike dhe palët e tjera nga fusha e kulturës për të promovuar dhe arritur qëllimet e saj të politikave. Gjithashtu, një politikë e shëndoshë e kulturës duhet të jetë në përputhje me parimin e mosndikimit'.<sup>10</sup> Këtë parim për herë të parë e ka cekur Xhon Majnard Kejns (John Maynard Keynes) në vitin 1946, sipas të cilit, qeveria lokale dhe ajo qendrore, kontribuon në përkrahjen e artistëve

dhe artist përmes mekanizimit që është i ndarë nga politikat ditore partiake. Përmes këtij mekanizimi arti mbetet jashtë ndikimeve politike në përmbajtjen dhe natyrën e tij të shprehjes krijuese. Po ashtu, mbron politikanët nga llogaridhënia për veprat e artistëve që nganjëherë mund të jenë fyese, ofenduese apo problematike në ndonjë mënyrë apo tjetër.<sup>11</sup>

I vetmi dokument në Kosovë ku përmenden disa objektiva për sektorin e kulturës është Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH). Është interesante të theksohet se në dokumentin prej 226 faqesh, vetëm dy faqe i dedikohen kulturës. Në KASH 2015-2017, qeveria deklaroi se misioni i MKRS-së është 'krijim dhe hartim i politikës, mjedisit të duhur dhe mekanizmave për promovimin e aktiviteteve kulturore'. Më pas në

<sup>9</sup> Po aty.

<sup>10</sup> Intervista me David Karlsson; Intervista me Lotta Lekvall, 28 maj 2015.

<sup>11</sup> Komisioni për kulturë, medie dhe sport – Raporti i tretë 'Financimi i artit dhe trashëgimisë', Parlamenti i Mbretërisë së Bashkuar, 28 mars 2011, par. 10, <http://www.publications.parliament.uk/pa/cm201011/cmselect/cmcomeds/464/46402.htm>.

këtë dokument renditen disa objektiva, duke përfshirë përkrahjen për institucionet publike të ndërlidhura me sektorin e kulturës, përkrahja e sektorit të pavarur të kulturës.<sup>12</sup> Për të arritur këtë objektiv, qeveria do të përkrahë institucionet publike të ndërlidhura me kulturën, sektorin pavarur të kulturës dhe do të promovoj diplomacinë kulturore përmes infrastrukturës së përmirësuar kulturore. Veprimet specifike të cekura përfshijnë 'përkrahjen e institucioneve kulturore në krijimtarinë e tyre kulturore në: teatër, muzikë, film, arte pamore, vallëzim dhe libra'.<sup>13</sup> Për të plotësuar KASH-in, në Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës 2015-2018 (Programi i Qeverisë) zotohet rritja financimit si për sektorin publik të kulturës, ashtu edhe për atë të pavarur, reforma legjislative dhe përmirësimi i infrastrukturës

fizike.<sup>14</sup>

Qeveria e re ka deklaruar se në Programin e saj për vitet 2015-2018 do të hartohet strategjia e re për kulturë.<sup>15</sup> Një grup punues i përbërë prej 25 anëtarësh,<sup>16</sup> është krijuar dhe ka filluar me procesin e hartimit.<sup>17</sup> Disa ngatë intervistuarit kanë kritikuar qeverinë për mosftesën e shoqërisë civile apo përfaqësuesit e sektorit të pavarur të kulturës në grupin punues. Megjithatë, anëtarët e shoqërisë civile përfaqësohen në grupin punues, duke përfshirë edhe dy anëtarë të Forumit Kulturor dhe pesë artistë të pavarur.<sup>18</sup> Sipas MKRS-së, deri në fund të korrikut të vitit 2015 janë organizuar tri takime të grupit

14 Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2015-2018, i miratuar në Shkurt të vitit 2015, [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Government Programme 2015-2018\\_eng\\_10\\_mars.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Government%20Programme%202015-2018_eng_10_mars.pdf), pp. 68-70 [Programi i Qeverisë].  
15 *Po aty*, f. 69.

16 Intervista me Vehbi Miftarin, këshilltar i lartë politik, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, 27 korrik 2015.

17 Intervistë me Valon Kashtanjevën, drejtor, Zyra për të drejtat e autorit dhe të drejtat e ndërlidhura, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, 10 qershor 2015; Intervistë me Vehbi Miftarin.

18 Intervistë me Vehbi Miftarin.

12 'Korniza afatmesme e shpenzimeve 2015-2017', Ministria e Financave, Prill 2014, [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2015 - 2017.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Korniza%20Afatmesme%20e%20Shpenzimeve%202015%20-2017.pdf), p. 74-75.

13 *Po aty*.



punues, dhe drafti i parë pritet të përfundohet diku kah tetori apo në nëntor.<sup>19</sup> Procesi udhëhiqet përmes aktit administrativ, ku rregullohet mënyra e hartimit dhe miratimit të strategjive.<sup>20</sup>

Përkundër planit të qeverisë për strategji të re të kulturës, si dhe për objektivat dhe aktivitetet e saj, duket se qeveria ende po ka probleme në përkufizimin e një politike të qartë të kulturës. Disa nga të intervistuarit kanë shprehur shqetësime se në vend që të fillohet nga politika e gjerë dhe të shkohet në objektiva dhe më pastaj në veprime specifike, qeveria e Kosovës vazhdon të punojë në drejtimin e kundërt, duke filluar nga veprimet apo aktivitetet, në vend që të zbatojë aktivitetet të diktuar nga politikat. Përdërisa mund të jetë më lehtë të dilet me veprime të qarta

---

19 *Ibid.*

20 Udhëzimi administrativ nr. 02/2012 për procedurat, kriteret dhe metodologjinë e hartimit dhe miratimit të dokumenteve strategjike dhe planeve për zbatimin e tyre, 23 mars 2013, [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Draft\\_Udhezimi\\_Administrativ\\_Per\\_Strategjite\\_FI-NAL\\_2012\\_2\\_.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Draft_Udhezimi_Administrativ_Per_Strategjite_FI-NAL_2012_2_.pdf).

sesa me qëllime të përgjithshme të politikave, kjo bën që përpjekjet qeveritare të duken si të ndërmarra në baza *ad hoc* adhe pa vizion. Për të pasur një jetë të shëndoshë dhe stabile kulturore, Kosova ka nevojë që qeveria të përcaktojë qëllime afatgjata të politikave dhe që këto qëllime t'i udhëheqin veprimet. Në mënyrë që qeveria të hartojë një politikë të mirë kulturore, duhet të ketë një vizion të pozitës së jetës kulturore në Kosovë një afat të gjatë. Për ta ndihmuar këtë proces, është sugjeruar që qeveria ta bëjë një hulumtim, ku do të përfshihet akterët e kulturës nga të gjithë sektorët, shoqëria civile, ekspertët e fushës, etj. Një hulumtim i tillë duhet të analizojë në mënyrë të duhur politikat kulturore të vendeve të tjera, posaçërisht të vendeve të BE-së, pasi që Kosova është në rrugën e vet drejt integritimit në Bashkimin Evropian.<sup>21</sup> Disa po ashtu kanë sugjeruar se qeveria duhet të sigurohet që të identifikohen sektorët e kulturës në Kosovë

21 Intervistë me David Karlsson.

për të parë se ku janë të nevojshme investimet dhe ku ekziston talenti më i madh. Një identifikim i sektorit të kulturës apo industrisë kreative është bërë nga projekti *Culture for All* (Kultura për të gjithë),<sup>22</sup> por ky identifikim mund të jetë vjetërsuar, kështu që qeveria duhet t'i identifikojë të gjithë sektorët. Qeveria gjithashtu do të mund të kërkonte ndihmesë në hartimin e politikës kulturore nga organizatat e pavarura të kulturës në shtetet e tjera anëtare të BE-së, siç është ajo Nätverkstan në Suedi. Pasi që u kontaktua, organizata Nätverkstan shprehu gatishmërinë që t'i ndihmojë qeverisë në hartimin e politikës për kulturë dhe në organizimin e punëtorive, kurseve, etj, për ministritë dhe shërbyesit civilë në MKRS lidhur me politikën kulturore.<sup>23</sup>

22 'Raporti i vlerësimit për industrinë kreative' dhe 'Raporti për identifikimin e sektorëve të kulturës', Culture for All, 2010-2012, <http://www.culture-ks.org/pdf/creative%20industries%20and%20mapping%20report.pdf>.

23 Sipas David Karlsson, Nätverkstan do të ishte i gatshëm të ndihmojë qeverinë në hartimin e politikës kulturore.

# Korniza e tanishme juridike dhe vlerësimi

Në krahasim me vendet e tjera të hulumtuara për këtë raport, Kosova ka një kornizë juridike mjaft të hollësishme kur kemi të bëjmë me institucionet publike të kulturës, duke përfshirë shumë ligje specifike për sektorin. Kjo natyrisht se mund të shpjegohet përmes perceptimit për nevojën e pasjes së legjislacionit me rastin e rindërtimit të shoqërisë së pasluftës. Ekzistimi i legjislacionit për rregullimin e sektorit të kulturës si të tillë mund të mos jetë problem, mirëpo kjo varet nga esenca e ligjeve. Në rastin e Kosovës, legjislacioni për sektorët specifikë të kulturës përmban disa dispozita kundërtënëse, të cilat mund ta ngufasin krijimtarinë dhe ta bëjnë joproduktiv sektorin publik të kulturës.

Kushtetuta e Kosovës përmban dispozita lidhur me mbrojtjen e kulturës dhe të drejtave kulturore, me theks të veçantë në mbrojtjen e identitetit kulturor të komuniteteve dhe të trashëgimisë kulturore.<sup>24</sup>

24 Shih nenet 7,9, 58, 59, 81, 122, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, <http://www.kushtetuta->

Për më tepër, Kosova ka Ligjin për kulturë *Ligji nr. 02/L-057 për institucionet kulturore*, përmes të cilit rregullohen kushtet, kriteret dhe procedura për themelimin e institucioneve kulturore, karakteri i tyre, struktura organizative dhe menaxheriale, punët dhe aktivitetet, obligimet dhe përgjegjësitë, çështjet e statusit, si dhe çështjet e tjerapër aktivitetet dhe funksionimin e institucioneve të kulturës.<sup>25</sup> Sipas nenit 7, 'Institucionet publike të kulturës të rëndësisë së veçantë janë institucionet e themeluara në bazë të ligjeve të veçanta.' Rrjedhimisht, Kosova gjithashtu ka një numër ligjesh specifike për sektorë të caktuar, përmes të cilëve rregullohen funksionet e institucioneve të kulturës,<sup>26</sup> siç është *Ligji për te-*

[kosoves.info/repository/docs/Constitution.of.the.Republic.of.Kosovo.pdf](http://www.kosoves.info/repository/docs/Constitution.of.the.Republic.of.Kosovo.pdf)

25 Neni 2, Ligji nr. 02/L-57 për institucionet e kulturës, UNMIK/REG/2006/44, 18 gusht 2006, [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2006\\_02-L57\\_en.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2006_02-L57_en.pdf), [Ligji për institucionet e kulturës].

26 Galeria Kombëtare nuk është e rregulluar përmes legjislacionit, por në bazë të statutit të saj të nënshkruar nga ish-ministri i Kulturës: Statuti i Galerisë Kombëtare të Kosovës, Ministria

atrot;<sup>27</sup> Ligji për filarmoninë, operën dhe baletin e Kosovës (“Ligji për FOB”);<sup>28</sup> Ligji për kinematografinë;<sup>29</sup> dhe Ligji për ansamblin nacional të këngëve dhe valleve “Shota” dhe ansambleve të tjera (“Ligji për Shofën”).<sup>30</sup> Përmes këtyre ligjeve në përgjithësi rregullohet struktura qeverisëse e institucioneve publike (pra, përbërja dhe funksionimi i bordeve dhe i menaxhmentit), metodat financimit dhe mekanizmat e monitorimit. Megjithatë, ia vlen të

---

e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, 19 tetor 2012, [http://www.mkrs-ks.org/repository/docs/STATUTI\\_I\\_GKK.pdf](http://www.mkrs-ks.org/repository/docs/STATUTI_I_GKK.pdf).

27 Ligji nr. 04/L-106 për teatrot, 24 maj 2012, [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2005\\_02-L12\\_en.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2005_02-L12_en.pdf). [Ligji për teatrot].

28 Ligji nr. 02/L-59 për filarmoninë, operën dhe baletin e Kosovës, 1 qershor 2006, [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2006\\_02-L59\\_en.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2006_02-L59_en.pdf). [Ligji për FOB].

29 Ligji nr. 2004/22 për kinematografinë, 8 korrik 2004, [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2004\\_22\\_en.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2004_22_en.pdf). [Ligji për kinematografinë]. Përmes këtij Ligji themelohet Qendra Kinematografike e Kosovës dhe rregullohet puna e saj.

30 Ligji nr. 04/L-164 për ansamblin kombëtar të këngëve dhe valleve “Shota” dhe ansamblet e tjera, 28 mars 2013, <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Law%20on%20National%20Ensemble%20of%20songs%20and%20dances%20Shota%20and%20other%20Ensembles.pdf>. [Ligji për Shofën].

përmendet se *Ligji për institucionet e kulturës* veç përmban dispozitat për strukturat qeverisëse të institucioneve publike, duke përfshirë mandatin dhe funksionet e bordeve dhe këshillave drejtuese, si dhe drejtorëve e të tjerëve, siç janë drejtorët artistikë.<sup>31</sup>

Veçori për gjendjen në Kosovë është ekzistimi i shumë ligjeve në fushën e kulturës. Sa për krahasim, në Suedi, të gjitha ligjet themelore<sup>32</sup> që përbëjnë Kushtetutën përmbajnë rregulloret që janë drejtpërdrejtë relevante për fushën e artit dhe të kulturës, përveç ndoshta, *Akti i suksesionit* (përmes të cilit rregullohet suksesioni i monarkisë së Suedisë). Sido që të jetë, legjislacioni në fushën e kulturës është shumë i pakët. Mungesa e legjislacionit

---

31 Ligji për institucionet e kulturës, pjesa V, nenet 32-45.

32 Kushtetuta e Suedisë përbëhet prej katër ligjeve bazike: Instrumenti i qeverisë, Akti i suksesionit, Akti për lirinë e shtypit dhe Ligji themelor për lirinë e shprehjes. Shih faqen e internetit të Qeverisë së Suedisë <http://www.regeringen.se/sa-styrs-sverige/det-demokratiska-systemet-i-sverige/grundlagarna/>.

specifik për kulturën është tipar karakteristik i politikës kulturore të Suedisë. Ekzistojnë disa ligje specifike sektoriale, duke përfshirë atë për artet pamore dhe të aplikuara, trashëgiminë kulturore, bibliotekat, filmin dhe Ligjin për arkivat kombëtare. Megjithatë nuk ekziston legjislacion specifik për rregullimin e arteve performuese, ndërsa muzika është e rregulluar përmes legjislacionit për të drejtën e autorit.<sup>33</sup> Ngjashëm me këtë, në Mbretërinë e Bashkuar (MB) nuk ekziston një kornizë e përgjithshme legjislative për kulturën dhe nuk ka legjislacion specifik për kulturën. Mirëpo, nga ana tjetër ekziston një numër ligjesh lidhur me qeverisjen dhe financat, ku shumica tyre janë specifik për sektorët e caktuar, duke përfshirë Ligjin për artet pamore dhe të aplikuara, atë për artet performuese dhe muzikën, bibliotekat, trashëgiminë kulturore, për filmin,

33 Dr. Tobias Harding, "Country Profile Sweden", in Compendium of Cultural Policies and Trends in Europe, 15th edition 2014, Council of Europe, <http://www.culturalpolicies.net/>, f. 23-24, 27-30 [Profili i shtetit, Suedi].

etj.<sup>34</sup>

Gjatë intervistave janë dëgjuar kritika si për numrin e ligjeve, ashtu edhe për substancën e tyre, posaçërisht për efektin e këtij legjislacioni ndaj institucioneve publike, dhe është thënë se ligjet në Kosovë janë duke mbytur kulturën. Ndoshta do të ishte mirë që të kemi legjislacion, përmes të cilit krijohet korniza për institucionet publike kulturore dhe jepen udhëzimet për çështjet, siç janë struktura udhëheqëse, financimi dhe mbikëqyrja. Megjithatë, aspektet e caktuara të institucioneve kulturore nuk duhet të rregullohen nëse qeveria dëshiron që këto institucione t'i kontribuojnë një jete dinamike kulturore, ku krijimtaria lulëzon. Ligji që më së shumti është përmendur në intervista dhe i cili duket të jetë më kundërtënësi në këtë fushë është *Ligji për teatrot*. Në

34 Rod Fisher dhe Carla Figueira, "Culture Profile United Kingdom", in Compendium of Cultural Policies and Trends in Europe, 13th edition 2012, Council of Europe, <http://www.culturalpolicies.net/>, p. 56-61 [Profili i shtetit, MB].

këtë Ligj nuk parashihen vetëm strukturat udhëheqëse, financimi dhe mbikëqyrja e teatrove publike, por gjithashtu ka dispozitat ku parashihet numri i aktorëve që duhet të punësohen nga institucionet publike si në nivel qendror, ashtu edhe në atë komunal, si dhe numri i produksioneve që duhet të bëhen çdo vit. Në bazë të këtij Ligji, Teatri Kombëtar duhet të ketë një ansambël prej së paku 30 aktorëve,<sup>35</sup> ndërsa teatrot e qytetit (komunale) duhet të kenë një ansambël prej më së paku 10 dhe më së shumti 20 aktorëve.<sup>36</sup> Përveç kësaj, në Ligjin për teatrot parashihet që Teatri Kombëtar duhet të ketë së paku pesë premiera çdo vit.<sup>37</sup> Kjo mund të paraqes një përmirësim të vogël në krahasim me ligjin e vjetër, ku parashihej që Teatri Kombëtar duhet t'i realizojë 'së paku tri shfaqje në javë'.<sup>38</sup>

35 Law on Theatres, Article 7(4).

36 Po aty, neni 7(5).

37 Po aty, neni 6.

38 Ligji nr. 02/L-12 për teatrot, 23 mars 2005, [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2005\\_02-L12\\_en.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2005_02-L12_en.pdf), Article 25.

Dispozitat ku parashihet jo vetëm numri i aktorëve, por edhe numri i premierave të teatrit publik mund të ngufas krijimtarinë dhe mund të paraqes humbje të parave publike. Mënyra e udhëheqjes së një institucioni publik kulturor, sa aktorë janë të nevojshëm për produksionet dhe sa premiera e shfaqje janë të dëshirueshme dhe të realizueshme në bazë të financimit në dispozicion duhet të jenë vendime të menaxhmentit, të miratuara nga bordi. Gjithashtu është nënvizuar se *Ligji për teatrot* është dëshmi e një kontrolli të fuqishëm shtetëror dhe gjurmë e traditave të vjetra, ku nuk i jepet menaxhmentit të këtyre institucioneve liria që duhet ta kenë.<sup>39</sup> Në vend të rregullimit strikt të fushës së kulturës me legjislacion specifik sektorial, disa të intervistuar argumentuan se qeveria mund dhe do të duhej ta bënte këtë përmes rregulloreve dhe akteve të tjera administrative, apo madje edhe t'i lejë institucionet që të

39 Intervista me Lotta Lekvall, 19 qershor 2015.

# Forumi për zhvillimin e kulturës

vetërregullohen. Për shembull në Suedi, nuk ka ligje ku parashihet numri i aktorëve të punësuar në institucionin publik kulturor apo produksioni i institucioneve të tilla. Në vend të kësaj, qeveria udhëheq përmes resurseve të saj financiare dhe udhëzimeve vjetore qeveritare (të ashtuquajtura *regleringsbrev*), duke i dhënë detyra institucioneve publike kulturore.<sup>40</sup> Qeverisja përmes akteve administrative të këtij lloji natyrisht se do të ofronte më shumë fleksibilitet si reagim ndaj keqmenxhimit të institucioneve publike kulturore, pasi që ato akte nuk duhet të miratohen nga Kuvendi. Megjithatë, përderisa shumësia e ligjeve përmes të cilave rregullohen në detaje institucionet publike kulturore mund të ngufat krijimtarinë e menaxhmentit dhe dinamikën e këtyre institucioneve, një kornizë legjislative për institucionet e kulturës mund të ofroj stabilitet në një vend ku ndikimi politik ende paraqet shqetësim dhe ku aktet administrative do të mund

të përdroreshin për të ndryshuar institucionet publike kulturore sipas tekeve të ministrit. Këto çështje duhet të merren parasysh nga Qeveria e Kosovës gjatë shqyrtimit të politikës së saj të kulturës, si dhe nga shoqëria civile në kritikën e saj për gjendjen e tanishme dhe sugjerimet për ndryshime.

# Financimi i kulturës

Çështja e financimit publik të kulturës sipër institucionet publike, ashtu edhe për sektorin e pavarur, ka dalë të jetë një nga shqetësimet kryesore gjatë intervistave të realizuara. Sipas legjislacionit të Kosovës, është qeveria ajo që duhet të financojë institucionet publike, dhe gjithashtu mund të jep përkrahje sektorëve të pavarur të kulturës. Megjithatë, shumica e të intervistuarve nga sektori i pavarur kan shprehur shqetësimin dhe frustrimin për mungesën e kriterëve të qarta si në nivelin qendror, ashtu edhe në atë komunal, për ndarjen e fondeve dhe për arbitraritetin e perceptuar në marrjen e vendimeve se nëse duhet të shpërndahen fondet për aktorë të caktuar të pavarur kulturor. Vendimi që veçanërisht është konsideruar si arbitrar dhe pa motivim është ai i ministrit të ri të Kulturës për zvogëlimin e fondeve, e nganjëherë ndërprerjen e tyre të plotë, për festivalet kryesore të kulturës. Ky vendim ka hasur në kritika të rrepta dhe ka pasur thirrje

edhe për dorëheqje të ministrit.<sup>41</sup> Ky vendim duket se është në kundërshtim me zotimin e qeverisë në Programin e saj qeveritar për rritjen e fondeve për ‘skenën e pavarur kulturore’, duke përfshirë ‘festivalet e ndryshme të muzikës dhe filmit’.<sup>42</sup>

Po kështu, ka pasur kritika për procesin e hartimit të *Ligjit të ri për sponsorizime dhe donacione*, të paraparë në kuadër të Programit qeveritar 2015–2018.<sup>43</sup> Në fillim të qershorit 2015, MKRS-ja ka organizuar procesin përfundimtar të konsultimit publik për këtë propozimligj. Megjithatë, sipas Rrjetit të Institucioneve të Pavarura Artistike dhe Kulturore (RRIPAK), procesi është karakterizuar me ‘mospërfshirje të plotë në grupin punues dhe në tërë procesin të

41 ‘Buxhetet për festivalet e kulturës, kërkohet dorëheqja e ministrit’, Top-Channel, 24 mars 2015, <http://top-channel.tv/lajme/artikull.php?id=295498>; ‘Artistët kërkojnë shkarkim të ministrit të Kulturës, Kujtim Shala’, Kallxo.com, 24 mars 2015, <http://live.kallxo.com/sq/MTL/Artistet-Kerkojne-Shkarkim-te-Ministrit-te-Kultures-Kujtim-Shala-5656>.

42 Programi i qeverisë, f. 68.

43 Po aty, f. 69.



përfaqësuesve të artit publik dhe institucioneve kulturore, si dhe të institucioneve të pavarura artistike e kulturore.<sup>144</sup> Përveç kësaj, 'mungojnë edhe ekspertët kredibil e po ashtu mungojnë edhe institucionet e pavarura jofitimprurëse. Shoqatat e biznesit që promovojnë mundësitë ekonomike dhe interesat e biznesit në Kosovë gjithashtu janë lënë jashtë procesit.<sup>145</sup>

Financimi i institucioneve të kulturës natyrisht që është i rëndësisë thelbësore, ku qeveria do të bënte mirë të merrte parasysh shqetësimet e palëve me interes në fushën e kulturës në strategjinë e saj të re për kulturën.

---

44 Email nga RrIPAK i datës 26 qershor 2015.

45 Po aty.

# Institucionet publike kulturore

Në bazë të *Ligjit për institucionet e kulturës*, institucionet publike të kulturës që themelohen apo bashkëthemelohen nga Kuvendi i Kosovës ‘financohen nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës’.<sup>46</sup> Rrjedhimisht, *Ligji për teatrot*, *Ligji për FOB*, *Ligji për kinematografinë* dhe *Ligji për Shotën* përmbajnë dispozita për financimin e institucioneve publike nga qeveria si ajo qendrore, ashtu edhe komunale, në rastet kur institucionet e tilla ekzistojnë në të dyja nivelet. Institucionet kombëtare kulturore marrin financime nga buxheti nacional.<sup>47</sup> Në *Ligjin për teatrot* dhe *Ligjin për FOB* parashihet që Teatri Kombëtar dhe FOB të marrin fonde nga buxheti për mbulimin e shpenzimeve operacionale, mirëpo, këto institucione duhet të aplikojnë për mjete financiare përkritazi me projekte të tjera përmes një thirrjeje apo shpalljeje publike.<sup>48</sup>

46 Ligji për institucionet e kulturës, neni 63.

47 Ligji për teatrot, neni 19; Ligji për FOB, neni 68; Ligji për kinematografinë, neni 48; Ligji për Shotën, neni 22.

48 Ligji për teatrot, neni 19; Ligji për FOB,

Institucionet komunale kulturore financohen nga buxheti i komunës së tyre përkatëse ku funksionojnë.<sup>49</sup> Megjithatë, ato po ashtu mund të aplikojnë për financime të projekteve nga MKRS-ja.<sup>50</sup> Institucionet publike lejohen sipas ligjit të kenë burime alternative të financimit, siç janë të hyrat vetanake, donacionet, sponsorizimet , etj.<sup>51</sup>

Në *Ligjin për teatrot dhe Ligjin për FOB* gjithashtu parashihet që qeveria duhet të siguron që Teatri Kombëtar, si dhe Filarmonia, Opera e Baleti të auditohen së paku një herë në vit.<sup>52</sup> Komunat kanë përgjegjësinë e njëjtë lidhur me teatrot komunale.<sup>53</sup> *Ligji për kinematografinë* gjithashtu përmban dispozitat për mbikëqyrje nga ana e Ministrisë të punës së Qendrës Ki-

---

neni 68.

49 Ligji për teatrot, neni 19; Ligji për Shotën, neni 23.

50 Ligji për teatrot, neni 19; Intervista me Vehbi Miftarin.

51 Ligji për FOB, neni 68; Ligji për kinematografinë, neni 48; Ligji për teatrot, neni 19; Ligji për Shotën, neni 22 dhe 23.

52 Ligji për teatrot, neni 19(6); Ligji për FOB, neni 59.

53 Ligji për teatrot, neni 19(7).

nematografike të Kosovës (QKK).<sup>54</sup> Disa të intervistuar kanë shprehur shqetësime lidhur me financimin e institucioneve publike të kulturës. Disa syresh kanë shprehur shqetësime për vetëcensurimin apo censurimin e tërthortë për shkak të kontrollimi të financimit nga qeveria. Për më tepër, të hyrat e krijuara nga institucionet publike duhet të kthehen në buxhetin e qeverisë në formë të hyrave të MKRS-së në vend që t'u mundësohet këtyre institucioneve që të riinvestojnë këto mjete apo së paku që të vendosin se si t'i shfrytëzojnë më së miri. Kjo mund të jetë destimuluese për institucionet publike të kulturës që madje edhe të tentojnë të krijojnë të hyra vetanake.<sup>55</sup> Megjithëkëtë, me rastin e reagimit ndaj këtyre kritikave, përfaqësuesit e MKRS-së kanë deklaruar se kjo praktikë do të ndryshon.<sup>56</sup>

Lidhur me sponsorizimin dhe

---

54 Shih Ligjin për kinematografinë, nenet 22 dhe 24.

55 Pozhegu, f. 38.

56 Intervistë me Vehbi Miftarin.

donacionet si burime alternative të financimit, është me rëndësi të theksohet që këto mundësi janë të rëndësishme, por shumë shpesh të vogla nëse i krahasojmë me qarkullimin e përgjithshëm të organizatës së kulturës. Sponsorizimet dhe donacionet janë të vogla, por prapë nuk mund të shpërfillen. Njohuria është e nevojshme. Po ashtu, është me rëndësi të theksohet që në Evropë krijimi i aktiviteteve të kulturës të bazuara vetëm në sponsorizime dhe donacione është dëshmuar të jetë i vështirë, dhe financimi bazë nga shteti ka qenë i nevojshëm. Në Evropë, mesatarisht 10-15% e financimeve vjen nga sponsorizimet. Në Suedi kjo shifër është 2-5%. Kjo varet nga tradita dhe mundësitë e vendit, si dhe natyrisht nga gatishmëria e bizneseve për të sponsorizuar kulturën (natyrisht, bazuar në parimin e pavarësisë së palëve). Kultura në ShBA nga ana tjetër finanohet për sponsorizimeve dhe donacioneve. Pavarësisht kësaj, kjo

nuk ka mangësi pasi që sektori i kulturës bëhet më i ndjeshëm ndaj gjendjes ekonomike të bizneseve të përfshira, të cilat papritmas mund të tërheqin përkrahjen e tyre financiare. E njëjta natyrisht vlen edhe për shtetin, edhe pse financimi nga shteti ka prirje të jetë më i qëndrueshëm.<sup>57</sup>

Lidhur me çështjen e financimit alternativ të institucioneve publike, Galeria Kombëtare dallohet si mjaft e suksesshme në disa vite të fundit – kjo kryesisht falë drejtorit të saj, Erzen Shkololli. Në fakt, disa të intervistuar thanë se Galeria Kombëtare është i vetmi institucion publik kulturës që funksionon si duhet. Në bazë të z. Shkolollit, ai është përpjekur që ta bëjë institucionin e tij të dukshëm dhe të krijojë programe me standarde të larta.<sup>58</sup> Si rezultat i udhëheqjes së tij, Galeria Kombëtare ka krijuar partneritete vjetore me institucionet dhe organizatat e tjera, siç është

57 Korrespondenca përmes E-mail-it me Lotta Lekvall, 18 tetor 2015.

58 Intervista me Erzen Shkolollin, drejtor i Galerisë Kombëtare, 23 qershor 2015.

Këshilli Britanik, ErsteStiftung dhe të tjerë, të cilët rrisin fondet deri në 55% në vit. Fondet për projekte të dhëna nga qeveria<sup>59</sup> do të mjaftonin vetëm për ekspozita modeste. Në këtë vazhdë, partneritetet për Galerinë Kombëtare kanë qenë thelbësore që ajo të jetë në gjendje t'i ofroj qytetarëve programe të mira dhe të besueshme. Këto partneritete gjithashtu ia kanë mundësuar Shkolollit që Galeria Kombëtare të mos shfrytëzohet më me qira për qëllime të tjera, siç është teatri, akademitë përkujtime, etj, gjë që më parë ka qenë e zakonshme. Tani Galeria Kombëtare ka rreth 10 ekspozita në vit; katër janë të përhershme, katër Shkololli ia propozon Bordit dhe dy zgjedhen nga Bordi përmes thirrjes së hapur. Galeria Kombëtare dhe partnerët e saj gjithashtu u ofrojnë artistëve kosovarë mundësi të cilat përndryshe nuk do t'i kishin. Për shembull, përmes partneritetit me Ambasadën

59 Rreth 160,000 euro për vitin 2014 në bazë të z. Shkolollit. Korrespondenca përmes e-mail-it, 2 korrik 2014.

Amerikës, një herë në vit ftohet një artist i Kosovës për të ekspozuar veprat e tij në Nju Jork për një periudhë katërmujore.<sup>60</sup> Këto lloje të nismave për financim alternativ përmes partneriteteve qartazi se do të ishin të dobishme poër institucionet e tjera të kulturës. Megjithatë, Shkololli nuk ishte në dijeni nëse institucionet e tjera publike kanë pasur ndonjë sukses në grumbullimin e mjeteve financiare nga burimet alternative. Në shumicën e vendeve perëndimore, bordet e institucioneve të kulturës i sjellin financuesit tek institucionet apo vet anëtarët e bordeve vinë nga fondacionet që mund të kontribuojnë me fonde.<sup>61</sup> Megjithatë, kjo varet edhe nga përvoja e anëtarëve të bordit në grumbullimin e fondeve. Rrjedhimisht, çështja e grumbullimit të fondeve në Kosovë ndoshta do të duhej trajtuar nga menaxhmenti. Sido që të jetë, kjo do të varet shumë nga përvoja dhe njohuritë e individëve. MKRS-ja duhet ta ketë

këtë parasysh me rastin e emërimit të anëtarëve të bordit në institucionet publike të kulturës.

60 Intervistë me Erzen Shkolollin.

61 Po aty.

# Sektori privat apo i pavarur i kulturës

Në bazë të *Ligjit për institucionet e kulturës*, qeveria gjithashtu mund ta shfrytëzojë buxhetin për të përkrahur institucionet private të kulturës.<sup>62</sup> *Ligji për Shotën* dhe *Ligji për teatrot* përmbajnë dispozita të veçanta për financimin e institucioneve të pavarura.<sup>63</sup> Komunitat gjithashtu mund të financojnë sektorin e pavarur të kulturës. Megjithatë, shumë të intervistuar nga sektori i pavarur ishin kritik ndaj mënyrës se si MKRS-ja dhe Komuna e Prishtinës e kanë trajtuar financimin e projekteve të tyre.

Kritika më e shpeshtë e bërë nga të intervistuarit kishte të bënte me mosekzistimin e kriterëve të qarta për pranimin e fondeve, duke përfshirë edhe llojin e aktiviteteve dhe gjërave që mund të financohen, udhëzimet e qarta për aplikim në nivel të qeverisë dhe atë komunal, si dhe transparenca në përzgjedhjen e projekteve. Kjo ua vështirëson pjesëtarëve të sektorit

62 Ligji për institucionet e kulturës, neni 63.2.

63 Ligji për Shotën, neni 24; Ligji për teatrot, neni 19.

të pavarur të kulturës që të dinë nëse projektet e tyre kanë gjasa që të marrin fonde dhe që të planifikojnë paraprakisht. Për më tepër, sipas të intervistuarve, institucionet publike zakonisht nuk japin arsye për refuzim, siç mund të jetë për shembull mospërmbushja e kriterëve të caktuara, në rast se projektet refuzohen. Kjo jo vetëm bën që procesi të duket arbitrar, por gjithashtu ua vështirëson atyre nga sektori i pavarur i kulturës që të dinë se çka duhet të bëjnë ndryshe për thirrjen e ardhshme për aplikime. Disa të intervistuar akuzuan MKRS-në për vendime arbitrare lidhur me ndërprerjen apo dhënien e financave ose edhe për dhënien e financimeve atyre që nuk kanë aplikuar fare gjatë thirrjes së hapur. Është e qartë se procesi i vlerësimit të projekteve duhet të bëhet në mënyrë transparente dhe të besueshme, me kriterë të qarta të financimit nga qeveria apo komuna, ku me rastin e refuzimit të projekteve, duhet të jepen edhe arsyet. Po ashtu

është sugjeruar që vendimet për financime nuk merren domosdo në bazë të meritokracisë, dhe se nevojiten masat më të mira të kontrollit të cilësisë në këtë proces. Në mesin e disa të intervistuarve gjithashtu ekzistonte perceptimi se cilësia e projekteve thjesht matet nga numri i shfaqjeve, gjë që nëse është e vërtetë, do të ishte shqetësuese. Më tej është sugjeruar që kjo duhet të bazohet në kritere, siç është numri i mysafirëve, madhësia e audiencës, numri i biletave të shitura, etj. Gjithashtu, ekziston nevojja për transparencë më të madhe e procesit kur institucionet pranojnë fonde nga qeveria dhe shumave që ato pranojnë. Kjo informatë duhet të jetë në dispozicion në faqet e internetit të MKRS-së dhe komunave sapo që të merret vendimi. Po kështu, do të ishte e dobishme që të ceket lloji i aktivitetit të financuar. Përveç kësaj, disa të intervistuar shprehen shqetësimin me faktin se qeveria nuk jep informata për alternativat e financimit.

MKRS-ja do të mund të ofronte një platformë në internet me këshilla për pjesëtarët e sektorit të pavarur të kulturës lidhur me mënyrat e aplikimit për përkrahje financiare të paraparë për OJQ-të. Për shembull, Këshilli Anglez i Arteve ofron linqe apo vegëza në faqen e internetit të tij për burimet e tjera të financimit, posaçërisht për aktivitetet që nuk mund t'i financojë vet.<sup>64</sup>

Një kritikë tjetër që është bërë shpesh është se vendimet e MKRS-së dhe të Komunës së Prishtinës për atë se kush do të financohet vinë mjaft vonë. Një intervistuar tha se deri në fund të majit nuk ka pasur vendim qoftë nga MKRS-ja apo Komuna për atë se nëse do të marrin fonde për vitin 2015. Praktikantët e tilla e vështirësojnë shumë për pjesëtarët e sektorit të pavarur të kulturës që të planifikojnë gjatë vitit, pasi që mund t' shpenzojnë para në projekte në fillim të vitit, për të cilat më vonë

---

64 Faqja e internetit e Këshillit anglez të arteve, <http://www.artscouncil.org.uk/funding/apply-funding/other-sources-of-arts-funding/>.

nuk do të marrin financime dhe, rrjedhimisht, do të paguhen nga paratë vetanake. Në nivelin komunal, për këtë situatë është fajësuar mungesa e menaxhimit të mirë.<sup>65</sup> Megjithatë, drejtori i Departamentit të kulturës në Komunën e Prishtinës thekson se kjo gjendje ka ardhur si rezultat i vonës miratimit të buxhetit komuna.<sup>66</sup> Sido që të jetë, kjo çështje duhet të zgjidhet si në nivel nacional, ashtu edhe në atë komunal.

Drejtori i Departamentit të kulturës, rinisë dhe sportit në Komunën e Prishtinës, pranon se financimi ka qenë çështje e madhe për sektorin e pavarur të kulturës. Megjithatë, komuna tanimë ka zbatuar apo do të zbatojë një numër masash që do të përmirësojnë gjendjen e sektorit të pavarur të kulturës kur kemi të bëjmë me financimin. Pikësepari,

---

65 Intervistë me Valbona Shujakun, Komuna e Prishtinës, Departamenti i kulturës, rinisë dhe sportit, 24 qershor 2015.

66 Intervista me Saranda Bogujevcin, drejtoreshë e Departamentit të kulturës, rinisë dhe sportit, Komuna e Prishtinës, 25 qershor 2015.

këtë vit do të bëhet ndarja e parave për projekte të sektorit të pavarur të kulturës. Kështu, institucionet komunale do të kenë linjën e vet të ndarë buxhetore për sektorin e pavarur, me linja të ndara për çdo nënsektor, p.sh.: për festivale vjetore, muzikë, arte pamore, film, teatër, etj. Gjithashtu do të ekzistojë mundësia për nënshkrime të memorandumëve të mirëkuptimit mes Komunës dhe festivaleve lidhur me financime vjetore nga ana e Komunës. Po kështu, sistemi i aplikimit për kërkim të fondeve do të bartet online dhe do të përfshinë kriteret specifike dhe formulari i aplikimit. Duke filluar nga viti 2016, do të ketë thirrje të posaçme për aplikime një herë në vit për çdo sektor me linjë të ndarë buxhetore. Aplikacionet do të dërgohen në fillim të vitit, ndërsa Komuna do të përpiqet t'i merr vendimet për aplikacione deri kah mesi i shkurtit. Juria që do të merr vendimet do të jetë e përbërë prej tre anëtarëve pavarur, të propozuar nga Departa-



menti i kulturës, rinisë dhe sportit apo një anëtar nga jashtë Departamenti që do të emërohet nga kryetari i komunës, dhe dy anëtarë nga Departamenti.<sup>67</sup>

Masa të ngjashme mund të ndërmerret MKRS-ja për të siguruar procedurë më të drejtë dhe transparente për financimin e sektorit të pavarur. Teatri Kombëtar, FOB, GKK, ansambli Shota dhe Galeria Kombëtare supozohet se do të ndahen në linja të veçanta buxhetore.<sup>68</sup> Kjo duket të sugjeron se së paku do të ketë ndarje të fondeve për sektorin publik dhe atë të pavarur të kulturës. Në bazë të informatave të dhëna nga MKRS-ja, linjat buxhetore për institucionet kombëtare, ato komunale dhe pjesëtarët e sektorit të pavarur tanimë janë të ndara. Lidhur me kritikën për procesin e e thirrjeve të hapura për aplikime për financim, MKRS-ja pranon kritikën

si pjesërisht të arsyeshme. Sipas kritereve për financim të MKRS-së, aplikacionet ekzistojnë, por Ministria pajtohet se ato nuk janë të qarta. Për më tepër, Ministria deklaroi se vonesat në marrjen e vendimeve lidhur me aplikacionet për financim kryesisht kanë ndodhur për shkak të mungesës së komunikimit. Për shembull, zakonisht ata që marrin fonde njohohen, por jo edhe ata aplikacionet e të cilve refuzohen.<sup>69</sup> Rregullorja për subvencione në kulturë është miratuar, e cila sipas MKRS-së specifikon kriteret për zgjedhjen e projekteve dhe përcakton një proces të qartë të vendimmarrjes.<sup>70</sup> E dyta, një rregullore e përmirësuar është duke u hartuar dhe kjo mund të përfundojë deri në shtator të vitit 2015.<sup>71</sup>

MKRS-ja ka shprehur dëshirën të përmirësojë proceset e aplikimit

67 Po aty.

68 'Institucionet e kulturës bëhen me nënkodet e veçanta buxhetore', Gazeta Express, 27 maj 2015, <http://www.gazetaexpress.com/arte/institucionet-e-kultures-behen-me-nenkode-te-vecanta-buxhetore-103842/>.

69 Intervista me Vehbi Miftarin.

70 Shih 'Rregullore (MKRS) për subvencionimin në fushën e kulturës, trashëgimisë kulturore, rinisë dhe sportit', Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, nr. 01/2015, 6 shkurt 2015.

71 Intervistë me Vehbi Miftarin.

dhe të vendimmarrjes lidhur me financimin e institucioneve dhe projekteve kulturore. Në bazë të ministrisë, planifikohet organizimi i dy thirrjeve publike çdo vit –njëra në fillim të vitit dhe tjetra në pjesën e dytë. Ideja do të jetë që ata që planifikojnë ta fillojnë projektin në fillim të vitit të aplikojnë në thirrjen e dytë publike gjatë vitit paraprak. Kështu, aplikuesit do t'i dinë rezultatet e aplikacionit të tyre shumë para datës së fillimit të projektit të planifikuar. Ata që planifikojnë të fillojnë projektet në pjesën e dytë të vitit do të aplikojnë në thirrjen e parë publike për atë vit. Në këtë vazhdë, ende ka diskutime nëse buxheti do të ndahet në dy pjesë – nga një pjesë për çdo thirrje publike – apo jo. Shqetësimi ka të bëjë me atë se nëse buxheti për thirrjen publike mbahet si shumë e njëhershme, dhe shumë aplikues aplikojnë gjatë thirrjes së parë, do të mbeten pak mjete financiare për aplikuesit në thirrjen e dytë. Nga ana tjetër, ndarja e buxhetit në

dy pjesë të barabarta do të kishte rreziqet të tjera. MKRS-ja thotë se këto çështje duhet të diskutohen me shoqërinë civile.<sup>72</sup>

# Modelet alternative për financimin e sektorit të pavarur të kulturës

Financimi për sektorin e pavarur të kulturës është jetik për çdo vend që dëshiron të ketë jetë kulturore funksionale dhe dinamike. Disa vende evropiane, siç është Suedia dhe MB-ja, financojnë sektorin e pavarur të kulturës përmes parimit të mosndikimit, qeveria vendos për shumën e financimit në dispozicion për sektorin pavarur, por nuk ndërhyjnë në mënyrën se si shpërndahen mjetet dhe këtë vendim ia lë institucioneve të ndara.<sup>73</sup> Në Suedi, Këshilli i Arteve i Suedisë (Statens Kulturråd) është agjenci e Ministrisë së Kulturës. Në bazë të qëllimeve të politikës kulturore të qeverisë, mandati i tij është të promovojë zhvillimin e kulturës dhe qasshmërinë ndaj saj përmes ndarjes së fondeve qeveritare për kulturë,<sup>74</sup> duke përfshirë për teatrin, vallëzimin, muzikën dhe ekspozitat.<sup>75</sup> Si i tillë, Këshilli i arteve i

73 Country Profile UK, f. 50; Intervista me

Lotta Lekvall, 28 maj 2015 dhe 19 qershor 2015.

74 Faqja e internetit e Këshillit të Arteve të Suedisë, <http://www.kulturradet.se/sv/Om-kulturradet/>.

75 Country Profile Sweden, f. 9.

ndihmon qeverisë në zbatimin e politikës së saj kulturore. Bordi i Këshillit të Arteve emërohet nga qeveria,<sup>76</sup> por institucioni është i pavarur në punën dhe vendimet e tij përndarjen e parave për projektet e caktuara.<sup>77</sup> Këshilli i arteve çdo vit merr udhëzime nga qeveria (*regleringsbrev*), ku ceket se sa para do të merr institucioni dhe si do të duhej që këto para të shfrytëzoheshin.<sup>78</sup> Këshilli Anglez i Arteve funksionon në të njëjtën mënyrë; bordi emërohet nga qeveria, e cila merr fonde për mbulimin e një vistri të gjerë të aktiviteteve në sektorin e pavarur të kulturës ‘nga teatri tek arti digjital, nga leximi tek vallëzimi, nga muzika tek letërsia, nga artizanatet tel koleksionet’ etj.<sup>79</sup> Qeveria e

76 Faqja e internetit e Këshillit të Arteve të Suedisë, <http://www.kulturradet.se/sv/Om-kulturradet/Organisation/>.

77 Intervistë me Lotta Lekvall, 19 qershor 2015.

78 Faqja e internetit e Këshillit të Arteve të Suedisë, <http://www.kulturradet.se/sv/Om-kulturradet/Regleringsbrev/>.

79 Faqja e internetit e Këshillit Anglez të Arteve, <http://www.artscouncil.org.uk/who-we-are/how-we-are-run/>, <http://www.artscouncil.org.uk/funding/>.

Kosovës do të mund të konsideronte themelimin e institucioneve të ngjashme,<sup>80</sup> pasi që këto modele të financimit të sektorit të pavarur të kulturës shihen si të duhura sepse vendimet nuk merren nga ministri i Kulturës apo nga njerëzit që punojnë në ministri. Natyrisht se do të ishte e rëndësishme që institucionet e tilla të veprojnë në mënyrë të pavarur, edhe pse bordi i tyre emërohet nga qeveria. Ky institucion do të duhej t'i shfrytëzonte fondet për promovimin e politikës kulturore, por duhet të jetë i lirë të vendosë se cilat projekte do t'i financojë në bazë të qëllimeve të politikave qeveritare, pa udhëzime nga qeveria.

---

80 Qendra Kinematografike e Kosovës është përgjegjëse për ndarjen e fondeve - ngjashëm me këshillat e arteve.

# Bordet dhe menaxhmenti i institucioneve publike të kulturës

Brenda shoqërisë civile të kulturës në Kosovë duket se ekziston shqetësimi lidhur me funksionimin e bordeve të institucioneve publike të kulturës dhe me marrëdhënien së tyre me menaxhmentin. Duket se ekziston perceptimi se bordet në përgjithësi nuk punojnë mirë, kanë tendenca të jenë mekanizëm ministrisë për kontrollin e institucioneve dhe se ndërhyjnë me punën e menaxhmentit të institucioneve të tyre përkatëse.

Disa të intervistuar deklaruan se struktura dhe organizimi i institucioneve publike është shumë i politizuar dhe se ministrinë zakonisht emërojnë anëtarë të bordeve njerëzit e afërt me ta. Më tej është thënë se anëtarët e bordit ushirojnë ndikim mbi menaxhmentin përmes favorizimit apo në aspektin e repertoarëve ose projekteve të institucioneve dhe madje mund të marrin vendime artistike në vend se ta menaxhojnë institucionin. Rrjedhimisht, disa të intervistuar kanë kërkuar mandate më të qarta për

bordet. Megjithatë, duhet të theksohet se *Ligji për teatrot*,<sup>81</sup> *Ligji për FOB*,<sup>82</sup> *Ligji për kinematografinë*,<sup>83</sup> dhe *Ligji për Shoftën*<sup>84</sup> përmbajnë dispozitat ku përcaktohen funksionet dhe përgjegjësitë e bordeve, këshillave drejtuese dhe menaxhmentit të institucioneve publike. Për më tepër, bordet duhet të takohen dy herë në muaj dhe anëtarët e tyre kryesisht marrin nga 100 euro për person për një mbledhje, përveç kryetarit të bordit, i cili merr 125 euro për një mbledhje.<sup>85</sup> Askush nuk kompensohet për ndonjë mbledhje tjetër. Megjithatë, disa të intervistuar deklaruan se shumë borde takohen thjeshtë për të marrë

81 Nenet 10-15.

82 Nenet 17-56.

83 Nenet 28-32.

84 Nenet 7-20.

85 Shih p.sh. 'Vendim për kompensimin e anëtarëve të Këshillit drejtues të Qendrës Kinematografike të Kosovës', Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, nr. 64/2014, 6 qershor 2014, <http://www.mkrs-ks.org/repository/docs/Kompensimi.pdf>; 'Vendim për emërimin e Këshillit drejtues të Teatrit Kombëtar të Kosovës', Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, nr. 02/2015, 12 janar 2015, [http://www.mkrs-ks.org/repository/docs/Vendim\\_per\\_emerimin\\_e\\_Keshillit\\_Drejtues\\_te\\_TKK.pdf](http://www.mkrs-ks.org/repository/docs/Vendim_per_emerimin_e_Keshillit_Drejtues_te_TKK.pdf).

kompensimin dhe se nuk zbatohet funksionet e tyre në mënyrë të duhur.

Pasi që autori ka mundur të intervistojë vetëm një drejtor të institucionit publik të kulturës dhe nuk ka pasur qasje në asnjërin prej anëtarëve të bordeve, është vështirë të përfitohet një pasqyrë e qartë për këtë çështje. Megjithatë, drejtori i Galerisë Kombëtare, Erzen Shkololli, thotë se nuk ka hasur në probleme me bordin paraprak.<sup>86</sup> Sipas z. Shkolollit, bordi i Galerisë ishte mjaft i besueshëm dhe asnjëherë nuk ka bllokuar përpjekjet e tij për zhvillimin e Galerisë sipas mënyrës së tij.<sup>87</sup> Andaj, kjo më parë mund të jetë çështje e integritetit dhe sjelljes personale të anëtarëve të bordeve apo këshillave drejtues dhe jo paqartësi e ligjeve. Megjithatë, ministri i Kulturës natyrisht se duhet të bëjë më të mirën e mundur për të emëruar anëtarët më

të mirë të bordeve, të cilët do të punojnë në kuadër të mandatit të tyre dhe me integritet drejt menaxhmentit të institucionit në fjalë për të mos ndërhyrë në punën e institucionit.

86 Bordi i ri është emëruar pas emërimit të ministrit të ri të Kulturës, por është ende herët të thuhet se cila do të jetë qasja e tij në menaxhimin e këtij institucioni.

87 Intervistë me Erzen Shkolollin.

# Çështjet e tjera

Disa të intervistuar për këtë raport shprehen shqetësimin për mungesën e shkollimit dhe të aftësive menaxhuese të njerëzve që punojnë në institucionet publike të kulturës, si dhe të atyre që punojnë në qeveri dhe komuna. Me këtë disa të intervistuar theksuan se vetëm një numër i vogël personash që menaxhojnë sektorin e kulturës kanë diploma në fushën e politikave kulturore apo të menaxhimit dhe se Kosova ka nevojë për njerëz të arsimuar në këto fusha. Po ashtu është deklaruar se ata që kanë njohuri për sektorin e kulturës apo që kanë aftësi të mira menaxheriale, por që nuk i përkasin ndonjë partie politike, kanë më pak gjasa të punësohen.<sup>88</sup>

Aftësitë menaxheriale dhe për politika kulturore janë jetike për njerëzit që punojnë në çështjet e kulturës në nivel të qeverisë dhe për ata në institucionet publike. Qeveria duhet të sigurohet që të gjithë të punësuarit të posedojnë shkathhtësitë dhe aftësitë e nevojshme. Nëse nuk ka të tillë në

Kosovë, qeveria mund të shqyrtojë mënyrat për krijimin e partneriteteve me ministritë, institucionet apo organizatat në vendet e tjera që kanë sektorë kulturor funksional dhe të mirë dhe të organizojnë punëtori, kurse, etj, për të përmirësuar shkathhtësitë e ministrave, shërbyesve civilë në MKRS dhe komuna, si dhe të palëve të tjera në sektorin e kulturës, duke përfshirë ata nga sektori i pavarur, të cilët mund të përfitojnë nga këto shkathhtësi.

# Përfundim dhe rekomandime

Që nga shpallja e pavarësisë në vitin 2008, të gjitha qeveritë e Kosovës kanë dështuar në krijimin e çfarëdo lloji të politikës koherente të kulturës. Për shkak të mungesës së njohurive dhe vizionit për sektorin e kulturës në Kosovë, qeveritë kanë vepruar sipas parimit *ad hoc* dhe në bazë të objektivave afatshkurtra të miratuara pa një politikë mbështetëse të qartë.

Kjo ka rezultuar me probleme të mëdha në fushën e kulturës, duke filluar nga çështjet e legjislacionit dhe rregulloreve, të financimit të institucioneve publike dhe të sektorit të pavarur të kulturës, të funksionimit dhe efektshmërisë së institucioneve publike kulturore, si dhe të mbikëqyrjes e llogaridhënies. Këto çështje duhet të jenë mjaft shqetësuese për cilëndo qeveri që ka qëllime serioze për krijimin e një jete kulturore cilësore dhe dinamike. Qeveria duhet t'i trajtojë shqetësimet si të institucioneve publike, ashtu edhe ato të sektorit

të pavarur, posaçërisht kur kemi të bëjmë me çështje të legjislacionit dhe rregulloreve, të financimit dhe të mbikëqyrjes. Në këtë vazhdë, GSPJ jep rekomandimet vijuese:



# Hartimi i politikës kulturore

1. Për të pasur një sektor të suksesshëm dhe dinamik të kulturës në Kosovë, nevojitet një politikë me qëllime afatgjata për sektorin e kulturës në Kosovë. Qeveria e Kosovës dhe MKRS-ja duhet të hartojnë një politikë të qartë kulturore, përmes së cilës caktohen qëllime të qarta për jetën kulturore në Kosovë, dhe në të cilat do të bazohen objektivat dhe veprimet. Kjo nuk do të thotë rregullore më të shumta dhe më të rrepta të jetës kulturore në Kosovë, por e kundërta, pasi që shumësia e ligjeve në fushën e kulturës mund të krijojë pasiguri dhe kontroll, si dhe të drejttojë më shumë se sa që duhet aktivitetet kulturore. Në vend të kësaj, zhvillimi i politikës kulturore duhet të përfshijë hartimin e një numri qëllimesh të politikave, përmes të cilave shpjegohet se çka dëshiron të arrijë qeveria përmes zhvillimit të jetës kulturore në Kosovë. Këto qëllime të politikave duhet të bazohen në parime të lirisë së shprehjes, tolerancës zero ndaj korrupsionit dhe marrëdhënies së mosndikimit mes qeverisë dhe sektorit të kulturës, si të atij publik, ashtu edhe të pavarur.
2. Për të hartuar një politikë të shëndoshë të kulturës, Qeveria e Kosovës duhet të përgatisë një hulumtim zyrtar për politikën e qeverisë në sektorin e kulturës, ku gjithashtu duhet të përfshihet identifikimi i të gjithë aktorëve të kulturës në Kosovë. Ky hulumtim duhet të drejtohet nga një individ i pavarur. Në këtë proces po ashtu duhet të përfshihet shoqëria civile, si dhe përfaqësuesit e të gjitha grupeve të krijuesve të kulturës në Kosovë.
3. Në kuadër të procesit të hartimit të politikës kulturore, qeveria duhet të përfshijë palët nga fusha e kulturës nga e tërë Kosova dhe të konsultohet me to. Qeveria gjithashtu do të mund të merrte parasysh t'i drejtohet ministrive të tjera të kulturës në shtetet e BE-së apo organizatave të pavarura të kulturës, siç është Nätverkstan për të mar-

rë këshilla dhe ndihmesë teknike. Në fakt, Bordi i Nätverskstan në Suedi është shprehur i gatshëm të ndihmojë qeverinë në hartimin e politikës kulturore në kuadër të programit nacional, ku Nätverkstan do të mund të udhëhiqte punëtoritë, kurset, etj, për ministrat, Ministrinë e Kulturës dhe departamentet, shërbuesit civilë në sektorin e kulturës, si dhe palëve nga ky sektor, për politikën e kulturës. Gjithashtu do të mund t'i ndihmonte qeverisë për çështjet rreth politikave dhe ekonomisë kulturore të BE-së, studimit të fizibilitetit, si dhe ndihmesës teknike ekonomike.

# Reformat ligjore

1. Duke pasur parasysh kritikën ndaj kornizës juridike në fushën e kulturës, qeveria duhet të merr parasysh shqyrtimin dhe ndryshimin e ligjeve që janë më problematike. Në fakt, në Programin e qeverisë për vitet 2015–2018 thuhet se qeveria 'do të shqyrton ligjet ekzistuese për fushat e caktuara për t'i bërë ato më të zbatueshme dhe nxitëse për zhvillimin e jetës kulturore në vend dhe në përputhje me praktikën ndërkombëtare.'<sup>89</sup> Kjo duhet të bëhet me qëllimin e zvogëlimit të numrit të ligjeve që rregullojnë sektorin e kulturës. Është me rëndësi jetike që ky proces të realizohet në mënyrë transparente dhe që të gjitha palët nga sektori i kulturës, të cilat preken nga ligjet në fjalë si nga institucionet publike, ashtu edhe nga ato të pavarura, të konsultohen në këtë proces, dhe po ashtu të konsultohen edhe ekspertët e tjerë nga fusha e kulturës.

2. Duke konsideruar kritikën

rrepta dhe mungesën e transparencës në procesin e hartimit të *Ligjit të ri për sponsorizim dhe donacione*, MKRS-ja duhet të rifillojë këtë proces për të përfshirë shoqërinë civile dhe sektorin e pavarur të kulturës, apo së paku që të sigurohet që këto grupe të konsultohen para vazhdimin të procesit. Ekspertët financiarë dhe të tjerë gjithashtu duhet të përfshihen, procesi i hartimit duhet të jetë transparent, si dhe informatat për përparimin e arritur duhet të jenë në dispozicion.

---

89 Program i qeverisë, f. 69.

# Financimi

Siç është qartësuar në kuadër të këtij raporti, aktualisht ekzistojnë probleme të mëdha lidhur me procesin e financimit të institucioneve kulturore dhe të palëve nga kjo fushë. Sektori i pavarur ka shprehur shqetësime për mungesën e informatave dhe mungesën e përgjithshme të transparencës gjatë procesit të përzgjedhjes së projekteve për marrjen e financimit nga qeveria. Andaj, qeveria duhet të merr parasysh rekomandimet si në vijim:

1. MKRS-ja duhet të ketë informata të qarta për mundësitë e financimit të sektorit të pavarur të kulturës. Të gjitha thirrjet për aplikacione për financime të projekteve duhet të kenë informata të qarta për metodat e aplikimit, duke përfshirë edhe formularë të qartë dhe të njëzuar të aplikimit. Për të lehtësuar procesin e aplikimit për sektorin e pavarur të kulturës, qeveria duhet të merr parasysh ofrimin e platformës online me këshilla për akterët nga

sektori i pavarur i kulturës lidhur me mënyrat e aplikimit për përkrahje financiare të organizatave joqeveritare.

2. MKRS-ja po ashtu duhet të ketë kritere të qarta për ndarjen e fondeve për projektet e kulturës dhe për vendimet për mosfinancimin e projektit të caktuar që duhet të përcjellën me arsytet për refuzimin e aplikacionit. Siç është parë më lartë, MKRS-ja pajtohet me këtë kritikë dhe është duke bërë disa ndryshime në këtë aspekt. Megjithatë, pasi që procesi i reformave nuk ka përfunduar, këto çështje duhet të merren parasysh. MKRS-ja fuqimisht duhet të konsideroj bashkëpunimin me shoqërinë civile lidhur me këto çështje.

3. Njashtu, është e rëndësishme që procesi i përzgjedhjes të jetë transparent dhe që llogaridhënia të jetë më e madhe. Anëtarët e komisioneve që marrin vendime për atë se cilat projekte duhet të finan-

cohen duhet të kenë njohuri nga fusha e kulturës. Anëtarëve nuk duhet t'u lejohet që të aplikojnë për financime të projekteve vetanake kulturore gjatë kohës së shërbimit në këto komisione.

4. MKRS-ja gjithashtu duhet të sigurohet që të organizoj thirrjet për aplikacione për financim në mënyrën që vendimet për financim të merren në fillim të vitit. Kjo do t'u sillte siguri akterëve nga fusha e kulturës pasi që do të dinë nëse do të marrin fonde apo jo. Po kështu, kjo do t'ua mundëson atyre të mos shpenzojnë fonde, të cilat më pas nuk do të mbulohen nga qeveria në rast të refuzimit të aplikacionit. Kjo nga ana tjetër do t'ua lehtësonte aktorëve nga fusha e kulturës që të planifikojnë në mënyrë të duhur dhe efikase projektet e tyre.

5. MKRS-ja po ashtu duhet të konsideroj ofrimin e financimit në shtigje më afatgjata dhe jo vetëm në baza vjetore, pasi që kjo pen-

gon planifikimin afatgjatë të institucioneve dhe akterëve nga sektori i pavarur i kulturës.

6. Si udhëzues për reforma lidhur me financimin që mundësisht do të mund të përmirësonte gjendjen për çështjet e lartcekura, MKRS-ja do të mund t'i qasej Komunës së Prishtinës.

7. Në mënyrë që parimi i mosndikimit të jetë udhëheqës për politikën e qeverisë lidhur me financimin e sektorit të kulturës, MKRS-ja mund të merr parasysh themelimin e institucionit të ngjashëm me ato në Suedi dhe MB, së paku për financimin e sektorit të pavarur. Kjo natyrisht se do të kërkonte që MKRS-ja gjithashtu do të duhej të siguronte se institucioni do të mund të punonte i pavarur dhe pa ndikime politike.

# Bordi dhe menaxhmenti

1. Ministri i Kulturës duhet të sigurohet që vetëm personat e kualifikuar të emërohen në borde të institucioneve publike kulturore, dhe mund të konsiderojnë motivimin e zgjedhjes së secilit anëtar të bordit në vendimin e publikuar, në vend të përmendjes së emrit të çdo anëtari të ri.

2. MKRS-ja duhet të sigurohet që puna e bordeve të bëhet në atë mënyrë që të sigurohet një transparencë dhe duhet të sigurohet që mekanizmat e mbikëqyrjes të jenë të duhur dhe të efektshëm.

# Përmirësimi i kapaciteteve

1. Për të trajtuar çështjen e mungesës së kapaciteteve dhe njohurive të atyre që punojnë në institucione publike të kulturës, MKRS-ja, komunat dhe Qeveria e Kosovës duhet të përkushtohen që në të ardhmen të angazhojnë njerëz me përvojë paraprake në sektorin e kulturës apo njerëz me diploma në menaxhimin e kulturës. nga ato shkathtësi. Qeveria mund të merr parasysh organizimin e një seminari apo punëtorie për politikanë dhe shërbyes civilë lidhur me parimin e mosndikimit. Edhe këtu, organizata Nätverkstan nga Suedia ka shprehur gatishmërinë të ofroj shërbime, siç janë punëtoritë, ligjëratat, etj, në bashkëpunim me qeverinë.

2. Për të rritur kapacitetet dhe njohuritë e atyre që punojnë në institucione publike të kulturës, MKRS-ja, komunat dhe, posaçërisht, nëse zbatimi i pikës nr. 1 dëshmohej të jetë i vështirë, Qeveria e Kosovës duhet të kërkojë ndihmesë prej ministrive, institucioneve apo organizatave në vende të tjera, të cilat kanë sektorë të kulturës që funksionojnë mirë për t'i ndihmuar qeverisë në përmirësimin e shkathtësive dhe aftësive të ministrave, shërbyesve civilë në MKRS dhe komuna, si dhe për aktorët e tjerë në sektorin e kulturës, duke përfshirë ata nga sektori i pavarur, të cilët mund të përfitojnë

# SHTOJCA I: Intervistat

Ilir Bajri, drejtor i Prishtina Jazz Festival. Intervistë e dhënë më 17 qershor 2015.

Michele Bergdoll, menaxher i projektit, projekti për Promovimin e diversitetit kulturor, Këshilli i Evropës. Intervistë e dhënë më 10 qershor 2015.

Saranda Bogujevci, drejtoreshë e Departamentit të kulturës, rinisë dhe sportit, Komuna e Prishtinës. Intervistë e dhënë më 25 qershor 2015.

Visare Gorani-Gashi, aktiviste për të drejta të njeriut. Intervistë e dhënë më 23 qershor 2015.

David Karlsson, kryetar i bordit në organizatën Nätverkstan. Intervistë e dhënë më 14 qershor 2015.

Valon Kashtanjeva, drejtor, Zyra për të drejtën e autorit dhe të drejtat e ndërlidhura, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Intervistë e

dhënë më 10 qershor 2015.

Lotta Lekvall, drejtoreshë ekzekutive e Folkteatern Göteborg, anëtare e bordit të Kungliga Operan [Opera Kombëtare e Suedisë]. Intervista e dhënë më 28 maj dhe 19 qershor 2015. Korrespondenca përmes e-mail-it më datën 18 tetor 2015.

Beza Luzha, drejtoreshë e Festivalit Shopen. Intervistë e dhënë më 15 qershor 2015.

Florent Mehmeti, drejtor i Teatrit ODA. Intervistë e dhënë më 18 qershor 2015.

Vehbi Miftari, këshilltar i lartë politik, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Intervista e dhënë më 27 korrik 2015.

Eshref Qahili, drejtor i Galeria Qahili. Intervistë e dhënë më 11 qershor 2015.

Erzen Shkololli, drejtor i Galerisë



Kombëtare. Intervistë e dhënë më 23 qershor 2015. Korrespondenca përmes e-mail-it më 2 korrik 2014.

Valbona Shujaku, Komuna e Prishtinës, Departamenti i kulturës, rinisë dhe sportit. Intervistë e dhënë më 24 qershor 2015.

Dominique Thiange, udhëheqës i ekipit i organizatës Kultura për të gjithë. Intervistë e dhënë më 26 qershor 2015.

Blerita Zeqiri, regjisore dhe ish-Drejtoreshë për kulturë në Komunën e Prishtinës. Intervistë e dhënë më 24 qershor 2015.



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit European në Kosovë



Implementuar nga:





*forumikulturor.net*  
*facebook.com/ForumiKulturor*  
*twitter.com/forumikulturor*